



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 26 (827674)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 3 korrik 2020

Mbrojtja Kundërajrore Shqiptare në 89 vjetorin e krijimit të saj



Kundërajrori-Arma e suksesshme e Forcave të Armatosura

Mbrojtja Kundërajrore e hapësirës së kaltër shqiptare është një histori suksesi me mision gjithmonë të përmbushuar në kuadrin e funksionimit të armëve e shërbimeve në Forcat e Armatosura shqiptare. Krijimi i armës së MKA-së, e ka zanafillën që me krijimin e shtetit shqiptar sepse toka, deti dhe hapësira

ajrore ka qenë dhe mbetet e shtrenjtë dhe e shenjtëruar për ne shqiptarët. Në pikëpamje historiografike pas datës 4.12.1912 që është dita e krijimit të Ushtrisë Kombëtare shqiptare të gjitha armët dhe shërbimet kanë një datëlindje brenda shekullit XX. Ato lindën si domosdoshmëri e kohës... >>> faqe 2

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka

Në tetor starton programi bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura

Pesëdhjetë e tre nënkolonelë dhe majorë të FA shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovë përfunduan vitin akademik 2019-2020 në Akademinë e Forcave të Armatosura >>> faqe 3



MINISTRJA XHAÇKA:

Oficerët e rinj të FA diplomohen në SHBA



>>> faqe 3

Atashetë ushtarakë të Italisë e Rumanisë

Përfunduan detyrën kolonel Cornacchia dhe kolonel Tutuianutë

Në mjediset e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, u zhvillua të mërkurën paradite ceremonia e përfundimit të detyrës, të atashet ushtarak të Republikës së Italisë, kolonel Fabio Cornacchia dhe atashet ushtarak të Republikës së Rumanisë, kolonel Florin Tutuianutë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA...



>>> faqe 3

Forca Ajrore

Shpëtohen 6 të rinj të bllokuar në majën e Jezercës

Më 25 qershor 2020, 6 turistë nga Kosova mbetën të bllokuar në majën e Jezercës pas një ngjitje në mal. Pasi ata kuptuan se kishin humbur rrugën kërkuan ndihmë dhe u shpëtuan për mrekulli nga Forcat Ajrore. Është mësuar se operacioni ka nisur në orën 19:00 të datës 25 korrik 2020 dhe ka zgjatuar dy orë. Gjashtë... >>> faqe 5

KRIMI KIBERNETIK DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike-prioritet i MM dhe FA

faqe 5

HISTORI

Tosun Selenica, figurë historike dhe ushtarake kombëtare

faqe 15



Instituti Gjerman për Studime Globale dhe Zonale

Gjermania ka një përgjegjësi kryesore për forcimin e NATO-s

>>> faqe 8

Mbrojtja Kundërajrore Shqiptare në 89 vjetorin e krijimit të saj

N/kolonelene FIGALI GOLEMI
DEGA E BCU-së
Komanda e Forcës AjroreMbrojtja Kundërajrore
shqiptare misionare e suksesit

Mbrojtja Kundërajrore e hapësirës së kaltër shqiptare është një histori suksesi me mision gjithmonë të përmbushuar në kuadrin e funksionimit të armëve e shërbimeve në Forcat e Armatosura shqiptare. Krijimi i armës së MKA-së, e ka zanafillën që me krijimin e shtetit shqiptar sepse toka, deti dhe hapësira ajrore ka qenë dhe mbetet e shtrenjtë dhe e shenjtë për ne shqiptarët. Në pikëpamje historiografike pas datës 4.12.1912 që është dita e krijimit të Ushtrisë Kombëtare shqiptare të gjitha armët dhe shërbimet kanë një datëlindje brenda shekullit XX. Ato lindën si domosdoshmëri e kohës, për të plotësuar misionin fisnik të mbrojtjes së truallit shqiptar. Shekulli që shkoi megjithë kompleksitetin dhe problematikën që sollti mbart në vetvete një historik të natyrshëm sikurse për gjithë armët edhe për mbrojtjen kundërajrore. Që nga krijimi dhe procesi i zhvillimit të Mbrojtjes Ajrore shqiptare, është i lidhur me zhvillimin e mjeteve sulmuese ajrore, por dhe me domosdoshmërinë për kundërvënien ndaj këtyre mjeteve. Udhë e armëve të ushtrisë sonë, përfshi edhe Mbrojtjen Ajrore lidhet me përshatjen me gjendjen, mundësitë, detyrat dhe objektivat e kohës. Shteti Shqiptar që lindi më 1912-tën, dëshmoi vullnet dhe seriozitet për vet domosdoshmërinë e rolin e armëve kundërajrore për shkak të zhvillimeve fillestare të aviacionit në vendet fqinje të vendit tonë si në Itali në pragun e Luftës së Parë Botërore. Fqinjët tanë matanë Adriatikut dispononin një trupë pilotash rreth 150 pilotë dhe rreth 100 avionë të blerë. Më 5 qershor 1920 deri më 3 shtator 1920, në Luftën e Vlorës, para një shekulli, u shfaqën elementet fillestare të mbrojtjes ajrore, ku luftëtarët shqiptarë me armët e thjeshta bënë të mundur, zbulimin dhe rrëzimin e dy avionëve luftarakë italianë në frontin e luftës. Pas pak vitesh dhe fqinjët e tjerë u pajisën me avionë luftarakë, që i detyronë qeveritë shqiptare të kohës marrjen e masave kurndër sulmeve që mund të vinin nga ajri.

Durrësi, Shëngjini dhe
Saranda- me histori
89 vjeçare të MKA-së

Akti i parë për mbrojtjen ajrore shqiptare ishte dekreti mbretëror 89 vjet më parë në Tiranë, në Tiranën kryeqytet vetëm 11 vjeçar, të vendosur në Kongresin e Lushnjës. Më 1 korrik 1931, shpallet dekreti mbretëror, që ndryshe quhej dhe akti ligjor "Mbi organizimin e Ushtrisë Kombëtare", urdhërohet përhapja në pozicione zjarri e tre baterive të AKA-së, në portet Durrës, Shëngjin dhe Sarandë dhe kjo datë shënon krijimin e Mbrojtjes Ajrore shqiptare. Në këtë kohë Ushtria Kombëtare shqiptare kishte 680 oficerë, 540 nënoficerë, 5800 ushtarë, por edhe 820 kuaj, si dhe asete e pajisje të tjera modeste. Artileria simbolike e kësaj periudhe ishte modeste por shënoi lindjen e një arme të re, që do të konsolidohej në dekadat që do të pasonin. Lindja e Mbrojtjes Ajrore shqiptare përkon me qeverinë e Pandeli Evangjelit, që ishte qeveria e 28 shqiptare që prej qeverisë së Ismail Qemal Bej Vlorës të vitit 1912-1914. Komandant i Mbrojtjes Kombëtare shqiptare ishte Xhemal Aranitasi; ndërsa Shef i Shtabit të Përgjithshëm ose shef i shtatmadhorisë shqiptare

Kundërajrori-Arma e sukseshme e Forcave të Armatosura

Në 1 Korrik 1931 Ushtria Kombëtare shqiptare kishte 680 oficerë, 540 nënoficerë, 5800 ushtarë, por edhe 820 kuaj



ishte Gjeneral Divizioni Gustav Von Myrdach, i ftuar nga Mbretëria për të shërbyer dhe dhënë përvojën e tij në ushtrinë shqiptare. Armatimi dhe pajisjet e fillimit ishin modeste dhe që nuk plotësonin nevojat reale të mbrojtjes ajrore, çka u vërtetua me agresionin e prillit 1939, ku rezistenca ishte e papërfillshme dhe krejtësisht e pamjaftueshme, që coi edhe në pushtimin e vendit dhe bashkimin e ushtrive.

Mbrojtja Ajrore u rigjallërua
dhe u vu në provë edhe
gjatë Luftës Nacionalçlirimtare

Tashmë është e gjithëpranuar se në Shqipëri lufta u dominua nga luftëtarët vullnetarë të LANÇ, të cilët ishin edhe fitues të saj në koalicionin e madh ruso-anglo-amerikan. Përgjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, 1939-1944, mjetet e mbrojtjes nga ajri qenë efikase në zbulimin e asgjësimitin e avionëve dhe luajtën rol përcaktues në zhvillimin e luftimeve. Ndërsa në Shqipëri, në kuadrin e betejave dhe operacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, elementët e mbrojtjes nga rreziku ajror erdhën duke u përsosur nëpërmjet zbatimit të masave të maskimit, vrojtimit ajror dhe kundërveprimimit me armët e lehta të këmbësorisë dhe me ato të marra armikut, ose armët trofe. Zbatimi efikas i këtyre masave çoi në rrëzimin e një avioni nga partizanët e Pezës dhe të një avioni tjetër nga partizanët e çetës partizane të Mallkastrës. Gjatë luftës nuk munguan edhe rrëzimet të tjera të avionëve, që duhet thënë ishin edhe aksidentale dhe rrjedhojë e zhvillimit të ulët teknologjik. Nga ajri erdhën mysafirë të ftuar e të paftuar, që synonin asgjësimitin e lëvizjes çlirimtare, si dhe aviacioni i

aleatëve anglez e amerikan në ndihmë të Shqipërisë. Por sërish historiografia pranon modestësisht zhvillimin e MKA-së gjatë këtyre viteve të vështira e komplekse të luftës.

Misionare dhe e sukseshme
arma e MKA-së në
mbi gjysëm shekulli

Fakt është se gjysëmshkulli që shkoi ishte epokë që shkroi histori edhe në kuadër të Mbrojtjes Kombëtare Ajrore të Republikës dhe që njohu një rritje e zhvillim të jashtëzakonshëm ishte pikërisht gjysëmshkulli i dytë i shekullit të kaluar. Më 1945-1946, pas përfundimit të luftës, u bë grumbullimi i armëve kundërajrore trofe dhe u krijua shkolla e instruksionit të AKA. Ndërkohë një numër kuadrosh të rinj u dërguan për t'u përgatitur në shkollat ushtarake jashtë shtetit. Më 14 shkurt 1946 krijohet kompaia e VAIN-it, me detyrë vrojtimitin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet ajrore të zbuluara. Kjo ka hyrë në historikun e Mbrojtjes Ajrore si data e krijimit të Regjimentit të parë të Zbulimit Elektronik. Kjo ka qenë dhe ngelet një datë historike. Në fakt vitet e para pas çlirimit ishin edhe vitet kur pati edhe ndryshyeshmëri më të shpeshta strukturash, që u përputhën me strukturat e modeleve jugosllave dhe sovjetike. Viti 1946 pati ristrukturimin e dytë të kryer me urdhër A-1-66 "Tepër rezervat" i dt. 5.3.1946, që në fakt fillimi i organizimit u krye me urdhër Nr. A-1-218 "Rezervat" datë 2.4.1946. Ky urdhër vendosi në funksionim Komandën e Artilerisë, e cila u suprimua po brenda vitit 1946 me urdhër nr. M-8, "Tepër rezervat" datë 23.9.1946. Në muajt

prill dhe maj 1955, u arrit kompletimi me radarë llokativë të tipave P-8, P-10, P-20 dhe më 25 maj 1955 u krijua Batalioni Radioteknik, i cili u përhap në të gjithë territorin administrativ të vendit. Kjo shënon edhe krijimin e VKQ (Vendkomanda Qendrore), QOSA (Qendra Operacionale e Survejimit Ajror), që aktualisht është emërtuar Qendra e Kontroll Raportimit (QKR). Ngjarja që "kundërajrorësit" e llogarisnin gjithmonë me peshë ka qenë ajo e 14.11.1947 kur krijohet regjimenti i I-rë kundërajror në kryeqytet. Ky regjiment shërbeu si një shkollë e rëndësishme për përgatitjen e kuadrove të parë të Mbrojtjes Kundërajrore shqiptare (MKA-së). Pajisja në vazhdimësi me teknikë të re dhe me kuadro të kualifikur në shkollat tona ushtarake dhe ato jashtë vendit krijoi kushte për konsolidimin e mëtejshëm të Mbrojtjes Kundërajrore-MKA. Me një shpejtësi të konsiderueshme në pak vite u futën në armatim topat 57 m/m, 100 m/m, me drejtim automatik, topat 37 m/m dygrykësh, me shenjestrat automatike si dhe mitralozët 14,5 m/m katërtytësh. Mbrojtja kundërajrore u pa si një detyrë e veçantë dhe me mjaft rëndësi edhe në dekadat që pasuan. Në periudhën 1959 deri 1970 u shënu krijimin dhe konsolidimi i njësive të raketave kundërajrore, që u bënë arma më speciale kundërajrore. Pajisja me raketa të drejtuara kundërajrore dhe radarë të zbulimit të largët e fuqizuan padyshim së tepërmi mbrojtjen ajrore shqiptare. Në ditën e përvjetorit të pavarësisë më 28 nëntor 1960 u vendos në pozicion zjarri grupi i parë i raketave të drejtuara kundërajrore; ndërsa më 6.12.1968 u krijua Regjimenti i Raketave të Drejtuara kundërajrore (RDKA). Është gjithashtu fakt se Shqipëria pas viteve 1970

kishte rreth 22 regjimente të Artilerisë Kundërajrore (AKA-së) si dhe 18 batalione mitraliere të AKA-së, që llogarisnin rreth 6 gryka zjarri për çdo kilometër të frontit të mbrojtjes shqiptare. Në vitet 1967 - 1972 sipas zhvillimeve ushtarake e kryesisht bazuar në dokumentacionin arkivor, mund të thuhet se shënojnë kulmin e zhvillimit të Mbrojtjes Ajrore, e cila pajiset me teknike të re dhe që shënon nivele të reja në përgatitje ushtarake e sidomos në gatishmëri. Në këtë periudhë gjysëmshkullore që është një ndër periudhat me të ndritura e më me shkëlqim të Mbrojtjes Kundërajrore shqiptare, ka pasur edhe lidhësinë që ka drejtuar me efikasitet, gjeneralë dhe komandantë të shquar që në këtë shkrim mund të përmendim: Rrahman Parllaku, Arif Hasko Mema (Tërbaçi), Sejdin Avdia, Halim Ramohito, Maqo Zoto, Kiço Janku, Naum Gjiniçkasi, Pali Prifti, Ylli Dimraj, Mehmet Metko, etj. Por Komanda e Mbrojtjes Ajrore ka pasur edhe mjaftë ushtarake të zotë që kanë spikatur në armën e Mbrojtjes ajrore dhe që kanë bërë emër si, Skënder Malindi, Maqo Zoto, Kiço Janku, Naum Gjiniçkasi, Arif Hasko, Rahman Parllaku, Halim Ramohito, Sejdin Avdia, Bejto Isufi, Jani Isaia, Pali Prifti, Fadil Toçi, Ylli Dimraj e shumë të tjerë. Njerëzit i japin jetë historisë dhe shtrirja me "Gjashtë gryka zjarri për çdo kilometër të frontit të mbrojtjes shqiptare", flet më shumë se një mijë fjalë.

Ristrukturimi i MKA-së
efektiv për kohën dhe
kompleksiteti i problemeve

Ristrukturimi i shekullit të ri në fakt nisi që në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar. Në vitet 1991-1992, dhe me vendosjen e demokracisë në Shqipëri si dhe me hapjen e vendit, u bë kërkesë e kohës ristrukturimi i ushtrisë dhe i Mbrojtjes Ajrore shqiptare. Si masë kryesore fillestare u gjykua përqëndrimi i mjeteve dhe kalimi në struktura drejtimi të reja dhe më efikase. Në atë kohë kishte 22 regjimente kundërajrore, 126 grupe të Artilerisë Kundërajrore-AKA e batalione të Mit-KA me rreth 1300 nënreparte duke përfshirë edhe togat e Mit-KA 12.7 m/m. Nuk kishte fshat i Republikës pa rojen operative të gatishmërisë luftarake të armatosur (ROGL), që kishte mitrolozin e tij kundërajrorë. Në vitin 1998 me riorganizimin që u bë ushtrisë shqiptare sipas modeleve perëndimore, krijohet Forca Ajrore dhe Mbrojtja Ajrore ingranohet në këtë strukturë. Gjithashtu në vitin 1998, Mbrojtja Ajrore dha një kontribut të veçantë për fitoren e luftës në Kosovë, me vrojtimin e pandërprerë të hapësirës ajrore dhe lehtësitë aeroportuale për gjithë aviacionin e NATO-s, i cili pati një impakt pozitiv në arritjen e objektivave të këtij operacioni luftarak historik. Gjithashtu përgjatë viteve të fundit janë (vijon në fq. 5)

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & KryeredaktorGazetarë:
Mimoza GOLIKJAGazetarë:
Saimir ALIJAGraphic Designer:
Afërdita HYSAJADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka

Në tetor starton programi bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura

Pesëdhjetë e tre nënkolonelë dhe majorë të FA shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës përfunduan vitin akademik 2019-2020 në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në kushte të veçanta dhe në një situatë tërësisht të pazakontë të krijuar nga pandemia COVID-19, duke respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat protokollare, u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të KLO dhe KKSHP.

Pesëdhjetë e tre nënkolonelë dhe majorë të FA shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës përfunduan me sukses vitin akademik 2019-2020 në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Nënkolonelët ndoqën për rreth 1 vit Kursin e Lartë të Oficerit, ndërsa majorët atë të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Në ceremoninë e përfundimit të këtyre dy kurseve, ditën e dielë, 28 qershor 2020, ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, Znj. Olta Xhaçka, SHSHPFA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, Atasheu ushtarak i Kosovës i akredituar në vendin tonë, Kolonel Bashkim Shillova.

Në ceremoninë e organizuar, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, përgëzoi oficerët dhe pedagogët për vullnetin për ta përfunduar vitin akademik edhe kushtet e vështira të diktuar nga pandemia.

“Jemi në prag të një ngjarje vërtet të rëndësishme, që është rezultat i një pune shumë të gjatë e të vështirë nga të gjithë ne. Pasi jemi duke kryer përgatitjet e fundit për të hapur programin bachelor në Akademinë e FA!

Jemi në prag të një momenti kur Akademia e FA do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA! Duke shërbyer si një institucion i mirëfilltë publik i arsimit të lartë!

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur kadro më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të thithur talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërtuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrtarë të Aleancës ku ne bëjmë pjesë.” - u shpreh ministrja Xhaçka.

Në fjalën e tij, komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, vlerësoi përkushtimin dhe seriozitetin e treguar, si nga e studentëve, e stafit akademik, personelit mbështetës në përvojën e re të krijuar nga situatë e pandemisë, duke e parë si sfidë që Akademia të jetë e përgatitur dhe në gjendje që të reagojë shpejt dhe me cilësi me çfarëdo lloji situatë.

“Sfida tjetër më e madhe për akademinë, - ka vijuar gjeneral Begaj, ka qenë dhe ristrukturimi i saj në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Në vijim të hapave të ndërmarrë për vënien në zbatim të VKM për statusin e akademisë tashmë është përfunduar procesi ligjor për hapjen e programit bachelor, duke kaluar në fazën e miratimit final zyrtar të përfshirjes në formularët e aplikimit të maturantëve, duke e bërë kështu të aksesueshëm për të gjithë ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e FA”.

Në përfundim, ministrja Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i KDS gjeneral brigade Bajram Bega dhe atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Tiranë, kolonel



Bashkim Shillova i dorëzuan diplomat Forca e Sigurisë së Kosovës, ndërsa kursantëve më të spikatur. Kursin e Komandës dhe Shtabit të

Kursin e Lartë të Oficerit e ndoqën Përgjithshëm e ndoqën 36 majorë, 6 17 nënkolonelë, mes të cilëve 2 nga prej të cilëve nga FSK.

Ministrja Xhaçka:



Oficerët e rinj të FA diplomohen në SHBA

Xhaçka vlerëson se oficerët nga Shqipëria u graduan me master në Amerikë, duke i bërë ata personel të FA të Shqipërisë, një nder i veçantë për Forcat tona të Armatosura.

Postimi i Olta Xhaçkës: Një e ardhme e mrekullueshme i pret Forcat e Armatosura me arsimimin e oficerëve të rinj në akademitë ushtarake më elitare të SHBA. Por një e ardhme dhe mundësi po kaq të mira i presin të gjithë ata të rinj e të reja që kanë vullnet dhe duan të bëhen pjesë e FA shqiptare.

Majorët Enkelejda Tyrku e Ermir Bejdo përfunduan kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas, ndërsa kapiteni i Rangut të III Blerim Hoxha e përfundoi në Neëport, Rhode Island. Dhe mbi të gjitha, na bënë krenarë duke u pajisur të tre me diploma masteri në fushën e studimeve strategjike!

ATASHETË USHTARAKË TË ITALISË DHE RUMANISË

Përfunduan detyrën kolonel Cornacchia dhe kolonel Tutuianutë

Në mjediset e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, u zhvillua të mërkurën paradite ceremonia e përfundimit të detyrës, të atasheut ushtarak të Republikës së Italisë, kolonel Fabio Cornacchia dhe atasheut ushtarak të Republikës së Rumanisë, kolonel Florin Tutuianutë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, drejtor drejtorish në MM dhe SHPFA, dhe atasheu ushtarak i SHBA në vendin tonë, kolonel James Hilton. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku në përshëndetjen e tij pasi i falënderoi të dy atashetë për kontributin e tyre në drejtim të bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis vendit tonë, Italisë dhe Rumanisë, u shpreh ndër të



tjera: “Dua t’ju shpreh një falënderim të veçantë për kontributin dhe ndihmën e dhënë nga këto dy shtete në përballimin e situatave të vështira që kaloi vendi ynë, atë të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe situatën e pandemisë

COVID-19.” Ceremonia u përmyll me dhënien nga SHSHPFA “Certifikatë mirënjohje” për dy atashetë. Ushtarakë në shenjë mirënjohje për kontributin e tyre të vyer gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës së tyre në vendin tonë.

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT-TIRANË

Aplikoni për 250 kandidatë ushtarë/detarë në 12 specialitete

Ja specialitetet: Muzikant, kuzhinier, infermieri, ndërlidhje, polici ushtarake, këmbësori, MZ, shofer, mirëmbajtje, motorist, xhenio dhe Roje. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është deri në 10 korrik 2020

Qendra e Personel Rekrutimit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes ka filluar më 1 Qershor 2020, regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 24 gusht- 30 tetor 2020, gjithsej 250 kandidatë, sipas rajoneve: Tiranë 120, Shkodër 40, Lezhë 4, Durrës 16, Vlorë 7, Berat 39, Elbasan 5, Burrel 1, Kukës 1, Gramsh 5 dhe Poliçan 12. Kurse 250 kandidatët gjithsej, do të shpërndahen në 12 specialitete si: Ndërlidhje 15, Polici Ushtarake 10, Këmbësori 82, MZ 2, Shofer 37, Mirëmbajtje 9, Kuzhinier 2, Motorist 1, Xhenio 2, Infermieri 11, Roje 76 dhe Muzikant 3. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në 10 korrik 2020.

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe i implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç; të kenë kryer arsimin parauniversitar apo të lartë brenda ose jashtë vendit; të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit; të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimin dhe përzgjedhjes, etj.



Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR

Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv paraqesin në Qendrën e Personel-Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme: a) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është: Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë,

përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit); fotokopjen e kartës së identitetit; çertifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi; dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm; fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar të noterizuar dhe çertifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/rrethit, e noterizuar ose të arsimit të lartë të noterizuar; diplomë, dëshmi, çertifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze,

të noterizuara; raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i aftë për punë; ekzaminimet mjekësore për agjentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit

Nëse kandidati shpallet fitues, brenda 2(dy) javëve duhet të sjellë në QPR edhe dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga gjykata; raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Qendra e Personel Rekrutimit, në bashkëpunim me strukturat që kanë akses në portalin "e-albania", të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarohet online nëpërmjet portalit qeveritar "e-albania", sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar, vetëm në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarohet nëpërmjet portalit. Qendra e Personel-Rekrutimit vijon procedurat e testimit dhe përzgjedhjes vetëm me kandidatët të cilët kanë paraqitur dokumentacionin sipas kriterëve të mësipërme.

Shënim: Dokumentacioni i aplikantit i plotësuar pranë Qendrës së Personel Rekrutimit nga aplikanti, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar prej tij, është pjesë e pandarë e dosjes personale të kandidatit për ushtarë/detarë aktiv.

KRIMI KIBERNETIK DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike-prioritetet i MM dhe FA

Forcat e Armatosura si strukturë e rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes janë objektivi i mundëshëm për keqbërësit kibernetikë

Në kuadër të sidomos vitet e fundit shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike është një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura duke bashkëpunuar me aleatët dhe vendet antare të NATO-s.

“Me zhvillimin e teknologjisë kanë evoluar edhe konceptet e sigurisë dhe mbrojtjes. Për këtë Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura i janë përshtatur sfidave të reja. Një “armatë” e tërë ushtarakësh e civilësh të padukshëm punojnë përditë për të siguruar të dhënat sensitive, informacionin dhe komunikimin e klasifikuar të Forcave tona të Armatosura, si një strukturë, pjesë e një organizate madhështore si NATO. FA në krye të detyrës”, thotë ministrja Xhaçka.

Kolonel Hamdi Doda, komandant i ASNI thote se “Krimi kibernetik është i lidhur me fusha të shumta të teknologjisë dhe informacionit. Pra është një mjedis kompleks që lind nga nënveprimi i njerezve, i programeve dhe shërbimeve në internet. Me anë të paisjeve dhe rrjedhjeve të teknologjisë por që nuk ekzistojnë në formë fizike, mbrojtja kibernetike përdoret kryesisht në kontekstin ushtarak ku ka të bëjë me aktivitetet kriminale sic është spiunimi. Qellimet e këtyre sulmeve varen nga marrja e informacionit, përfitimi i aksesit të paautorizuar dhe deri të infiltrimi në paisjet elektronike. Një pjesë e rrjeteve kompjuterike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura janë të nderveprueshme dhe aksesueshme në internet duke i bërë ato të cenueshme ndaj sulmeve të ndryshme kibernetike. Forca e Armatosur si strukturë e rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes janë objektivi i mundëshëm për keqbërësit kibernetik. Për këtë arsye vitet e fundit shtimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike është prioritet i MM dhe FA. FA shkëmben informacion dhe ekperiencë me NATO-n, aleatët, kjo në interes të zhvillimit dhe përmirësimit të aftësive të mbrojtjes kibernetike”.



ZJARRI NË PASHALIMAN

Helikopteri “Cougar” kryen operacionin nga ajri

Në Vlorë u zhvillua në date 30 qershor 2020, një operacion nga ajri për shuarjen e vatrës masive të zjarrit në zonën e Pashalimanit. Një helikopter i Forcës Ajrore i pajisur me mjetet e posaçme u përfshi në operacionin për shuarjen e zjarrit, pasi zjarri ra në një zonë me shkurre të dendura duke bërë të pamundur ndërhyrjen e zjarrrfikëseve. Po kështu Ministria e Mbrojtjes deklaroi se sipas raportimeve konkrete nga terreni, zjarri nuk ka rrezikuar bazën detare të Pashalimanit. Në terren ishin edhe mjetet zjarrrfikëse të Vlorës dhe Repartit të Pashalimanit, forca të MSZH, AdZM dhe forca ushtarake. Helikopteri Cougar ka përfunduar me sukses operacionin e shuarjes së zjarrit duke hedhur rreth 60.000 litra ujë që mundësoi shuarjen e tij.



FORCA AJRORE

Shpëtohen 6 të rinj të bllokuar në majën e Jezercës

Më 25 qershor 2020, 6 turistë nga Kosova mbetën të bllokuar në majën e Jezercës pas një ngjitje në mal. Pasi ata kuptuan se kishin humbur rrugën kërkuan ndihmë dhe u shpëtuan për mrekulli nga Forcat Ajrore.

Është mësuar se operacioni ka nisur në orën 19:00 të datës 25 korrik 2020 dhe ka zgjatur dy orë. Gjashtë turistët pasi u shpëtuan nga zona ku ishin bllokuar janë dërguar me helikopter në Theth në gjendje të mirë shëndetësore. “Një helikopter i Forcës Ajrore u angazhua në operacionin e kërkim shpëtimit në malin e Jezercës ku prej disa orësh ishin bllokuar 6 shtetas nga Kosovë. Operacioni nga ajri nisi rreth orës 19 dhe pak minuta më parë turistët u morën nga zona ku ishin bllokuar dhe u dërguan shëndoshë e mirë në Theth. Operacioni i Forcës Ajrore në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përfundoi me sukses”, thuhej në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.



(vijon nga fq. 2)
bërë përpjekje dhe janë shënuar rezultatet e para të modernizimit të Mbrojtjes Ajrore, në përshtatje me strukturat organizative të ushtrive të NATO-s. Mbrojtja Ajrore është në procesin e strukturimit që synon pajisjen e saj me sisteme e mjete, të cilat disponohen nga ushtritë anëtare të NATO-s, me qëllim arritjen e standarteve të kërkuara nga anëtarësimi në NATO. Vizioni dhe e ardhmja e Forcës Ajrore synon transformimin dhe modernizimin e Mbrojtjes dhe Vëzhgimit Ajror, duke rritur më tej bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë me vendet e NATO-s. Prioritetet kryesore të modernizimit janë, ndërtimi i një sistemi të vëzhgimit ajror të integruar me sistemin e NATO-s (NATINADS), kontrollin dhe menaxhimin e hapësirës ajrore së bashku me Aviacionin Civil. Detyrat strukturat e Mbrojtjes Ajrore i realizojnë në mënyrë të standardizuar, duke arritur të kemi një siguri më të lartë të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë, kjo edhe falë kontributit të vendeve anëtare të NATO-s, koordinatoreve tanë që punojnë në qendrat operacionale, si dhe bashkëpunimit me ANTA-n. Por nga ana tjetër një rol të

rëndësishëm në ecjen përpara dhe konsolidimin e Mbrojtjes Ajrore shqiptare ka luajtur dhe vazhdon të luajë trajnimi i personelit në shkollat perëndimore të NATO-s dhe të vendeve partnere, duke rritur kështu shkallën e profesionalizimit dhe të shkëmbimit të eksperiencave në fushën e mbrojtjes ajrore, konformë misionit tonë kushtetues dhe duke synuar të jetë në avantgardë të zbatimit të detyrave me cilësi dhe në kohën e duhur.

Mbrojtja Kundër Ajrore në “pushtetin” e lartësive gjeografike shqiptare

MKA-ja ka punuar gjithmonë me logjikën smart të kuptimit dhe zbatimit të misionit. Ajo ka qenë e ndërgjegjshme misionin e vështirë dhe të njohur për sakrificat të panumërta të efektivitetit të saj. Mbrojtja Kundërajrore shqiptare dhe Aviacioni shqiptar janë “takuar, ndarë e ritakuar” disa herë përsa i përket formës organizative e vartësisë strukturore, megjithëse duhet thënë se bashkëpunimi i tyre ka qenë gjithnjë i pashkëputur. Fakt është se që në fillimet e saj, arma e Aviacionit ka qenë pjesë e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore, gjë që ka vazhduar deri në vitin 1974 për t’u

bashkuar përsëri në Forcat e Mbrojtjes Ajrore në vitin 1995. Komandanti i parë i Aviacionit ka qenë zoti Edip Ohri, i cili e ka komanduar atë deri në vitin 1974. Nga viti 1975 e deri në vitin 1995, komandantë të Aviacionit kanë qenë Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj. Por sikurse shkruam edhe më lartë shumë ushtarakë të këtyre armëve, që kanë drejtuar e punuar në vite, janë nga figurat më të shquara të ushtrisë sonë kombëtare ku me krenari mund të përmendim Rrahman Parllaku, Gjini Marku, Hito Çako, Todi Naço, Sotir Filito, Arif Hasko, Edip Ohri, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Haki Jupasi, Perlat Binaj, Salih Dibra, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, Astrit Jaupi, Vait Golikja, Dilaver Goxhaj, Gëzdar Stroka, etj, të cilët kanë qenë të njohur në të gjithë radhët e ushtrisë për kryerjen e detyrave. E megjithatë jo të gjithë i përkasin armës së MKA, por shërbimi në aviacionin luftarak shqiptar ka qenë pazgjidhshmërisht me detyrat që kryenin “kundërajroresit” në shërbim të mbrojtjes së hapësirës ajrore shqiptare. “Kundërajroresit” kanë qenë “pushtuesit” e çdo maje në

hapësirën shqiptare, në gjysëmshkulli, që bashkë me misionin kushtetues janë përballur me qindra vështirësi jetese e shërbimi dhe që kanë ditur të përballojnë sfida dhe të triumfojnë mbi to në ditë të bardha por dhe në ditë rreziku. Në ditë feste kundërajroresit kujtojnë komandantin e parë të Mbrojtjes Kundërajrore Gjeneral Gjini Markun të lindur më 2.6.1918 në fshatin Bazë të Mirditës dhe që më 15.4.1955, me krijimin e Komandës së Mbrojtjes Kundërajrore të shtetit emërohet komandant i saj. Ai është shpallur “Qytetar Nderi” i Mirditës dhe hero i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në vitet që pasuan MKA-në e kanë komanduar Sotir Filito (1955 – 1956); Arif Hasko (1959-1966); Todi Naço (1967-1969); Bejto Isufi (1969-1971); Kiço Janku (1972-1975); Naum Gjini (1975-1982); Pali Prifti (1982-1992); Ylli Dimraj (1992-1995). Më vonë komandantë të FMA kanë qenë edhe Perlat Sula, Agim Baruti. Por të një rangui komandimi dhe drejtimi për një kohë prej tre dekadash (1.5.1966 deri 28.11.1991) kanë qenë edhe komisarët e MKA-së Rrahman Parllaku, Ilo Prifti, Xhemal Shehu, Halim Ramohitaj, Sejdin Avdia, Qani Duro, Simon Lesko, Paskal

Budo, që kanë qenë ushtarakë të nderuar dhe respektuar dhe që kanë dhënë kontribut të spikatur në ngritjen e konsolidimin e MKA-së. Mbrojtja Kundërajrore sëbashku me Aviacionin Luftarak si dhe me repartet e Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (VHA) pavarësisht nga format organizative të ndryshme në vite e dekada kanë qenë gjithnjë të lidhura e në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, por edhe me lidhje varësie e strukturore të ndryshme me njëra-tjetrën në vite. Ato i më shumë i ka “takuar” se sa “ndarë” misioni kushtetues i shenjtë që me të drejtë ka merituar respektin dhe mirënjohjen e mbarë popullit. Është kjo arsyeja që respekti e mirëshohja shkon për “kundërajroresit” në këtë ditë të 86 vjetorit të armës së MKA-së shqiptare. Ata ecnin dhe ecin me hapin e kohës tashmë si strukturë e konsoliduar, e standardizuar dhe e përbashkuar në Komandën e Forcës Ajrore, drejtues dhe lider të së cilës janë ushtarakët në detyrë Kolonel Edison Zarka si dhe stafi i tij, Kolonel Genci Petani, dhe shumë ushtarakë të lartë të të gjitha gradave ushtarake të përkushtuar në misionin e tyre kombëtar dhe përgjegjësitë e detyrave në kuadër Euroatlantik.

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT SHPALL APLIKIMET

Studime (2 kandidatë) në Institucionet Ushtarake të Kosovës

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit në Qendrën e Personel Rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në Tiranë, është deri në 6 korrik 2020. Krahas testeve që do zhvillohen nga Qendra e Personel Rekrutimit në Tiranë, kandidatët fitues do të testohen edhe nga Qendra për Studime Universitare në Kosovë

Qendra e Personel Rekrutimit, me 21 maj ka shpallur kriteret për rekrutimin e 2 kandidatëve për studime në Qendrën e Studimeve Universitare, në Kosovë. Studimet ushtarake ndiqen pranë Qendrës për Studime Universitare të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe studimet e larta universitare në Institutin Rochester të Teknologjisë, në Kosovë. Ndërsa afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 6 korrik 2020.

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Të ketë shtetësi shqiptare. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 21 vjeç, në datën e aplikimit. Të mos jetë i martuar. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të mos ketë tatuazhe në pjesët e dukshme të trupit. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zëmrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike.

Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në Qendrën e Studimeve Universitare të Kosovës të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, mbi 7 (shtatë). Të jenë njohës të mirë të gjuhës angleze (kandidatët do të testohen nga MFSK në testimin gjuhësor TOEFL). Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak; kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:



Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Qendrën e Studimeve Universitare të Kosovës. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton se ndjek vitin e fundit të studimeve parauniversitare si dhe listën e notave të vitit të parë, vitit të dytë dhe semestrin aktual. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografia për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga

mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. Ekzaminimet mjekësore për agentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin pas përfundimit të testimit

Dokumentacioni që duhet të

paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve: Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi. Vërtetim nga përmbartimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

Datat e testimit

Testimi i gjuhës së huaj (Anglisht) do të zhvillohet më datë 7.7.2020, testi fizik do të zhvillohet më datë 7.7.2020, testi intelektual do të zhvillohet më datë 8.7.2020, testi psikologjik do të zhvillohet më datë

8.7.2020. Krahas testeve të zhvilluara nga Qendra e Personel Rekrutimit në Tiranë, kandidatët do të testohen edhe nga Qendra për Studime Universitare në Kosovë, si dhe do të nevojitet dokumentacion për aplikim, për kandidatët e shpallur fitues në teste, si vijon: testimet që do të zhvillohen: testim matematik dhe gjuhësor (TOEFL); testim për udhëheqje/drejtim dhe testim i javës "zero".

Dokumentacioni për aplikim për kandidatët që do të shpallen fitues

Për kandidatët që do të shpallen fitues duhet dokumentacioni: diploma e shkollës së mesme së bashku me certifikatën dhe listën e notave; certifikatë lindje; kopje e kartës së identitetit/pasaportës dhe dy fotografi të formatit 5x5 cm.

Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë

Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë se: Jam: i/e padënuar apo i/e dënuar. Jam pa procedim penal në ngarkim apo me procedim penal në ngarkim. Jam pa proces penal në ngarkim apo me proces penal në ngarkim. Jam i/e pa gjykuar/padënuar jashtë vendit apo i/e gjykuar/dënuar jashtë vendit dhe jam i/e padetyrime përmbartimore apo i/e me detyrime përmbartimore.

Qendra e Personel Rekrutimit, kërkon të rekrutojë studentë për studime ushtarake në shkollat e larta ushtarake të Greqisë, 4 (katër) të drejta studimi si më poshtë vijon:

Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore "Evelpidon", specialiteti gjithëarmësh, 1 (një) kuotë, Akademia Ushtarake e Forcave Detare, (SND), 1 (një) kuotë, Shkolla Ushtarake e Oficerëve të Trupës, në mjekësi, 1 (një) kuotë. Shkolla Oficerëve të Infermierisë "SAN", 1 (një) kuotë. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është më 14 korrik 2020.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare, të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare, të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.

Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, të jetë i aftë nga ana shëndetësore, të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse, të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.

Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, jo më pak se 6.5 (gjashtë pikë pesë). Të jenë njohës i mirë i gjuhës angleze dhe niveli i saj duhet të jetë të paktën "B2" ose mbi 60 pikë në ELPT. Kandidati që do të jetë pjesë e Akademisë Ushtarake të Forcave Detare "SND" duhet të njohë shumë mirë notin.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak; kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake



Qendra e Personel Rekrutimit shpall aplikimet

Studime (4 kandidatë) në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është më 14 korrik 2020



brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në

Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton se ndjek vitin e fundit të studimeve parauniversitare si dhe listën e notave të vitit të parë, vitit të dytë dhe semestrin aktual (në

momentin e testeve duhet të sjellë certifikatën dhe listën e notave (të fotokopjuar dhe noterizuar). Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe

grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve: Dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor, vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi, vërtetim nga përmbartimi, raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko - Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

Datat e testimit:

Testi i gjuhës së huaj (Anglisht) do të jetë në datën 15.07.2020. Testi fizik do të jetë në datën 15.07.2020, Testi intelektual do të jetë në datën 16.07.2020 dhe testi psikologjik do të jetë në datën 16.07.2020

Deklaruesi duhet të deklarojë me vullnetin e tij të lirë se: Jam: i/e padënuar apo i/e dënuar. Jam: pa procedim penal në ngarkim apo me procedim penal në ngarkim. Jam pa proces penal në ngarkim apo me proces penal në ngarkim. Jam i/e pa gjykuar/padënuar jashtë vendit apo i/e gjykuar/dënuar jashtë vendit dhe jam i/e padetyrime përmbartimore apo i/e me detyrime përmbartimore.

NGA JENS STOLTENBERG

INSTITUTI GJERMAN PËR STUDIME GLOBALE DHE ZONALE

Gjermania ka një përgjegjësi kryesore për forcimin e NATO-s

Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg në Institutin Gjerman për Studime Globale dhe Zonale (GIGA)

Disa javë më parë paraqitën strategjinë "NATO 2030". Të mendojmë se ku e shohim Aleancën tonë dhjetë vjet nga tani dhe si do të vazhdojë të na mbajë të gjithë të sigurt. Një nga porositetet e mia kryesore është se NATO-ja duhet të bëhet më globale. Kështu që sot unë do t'i përqendroj vërejtjet e mia në tre shembuj se pse NATO-s i duhet një qasje globale. COVID-19, terrorizmi dhe ngritja e Kinës.

Së pari, COVID-19. Një krizë globale që tregon sesi diçka që filloi nga ana tjetër e botës mund të ketë pasoja të mëdha për të gjithë ne. Po ashtu në NATO. Detyra kryesore e NATO-s gjatë pandemisë është të sigurohet që kriza shëndetësore të mos bëhet krizë e sigurisë. Dhe në të gjithën, ne kemi mbetur të gatshëm, vigilentë dhe të përgatitur për t'iu përgjigjur çdo kërcënim. Ne kemi bërë atë që është e nevojshme për të mbajtur forcat tona të sigurta. Për të ruajtur gatishmërinë tonë operacionale dhe të mbajmë misionet dhe operacionet tona, nga grupet e betejave në Balltik deri në luftimin e terrorizmit në Afganistan. Përtej kësaj, ne kemi qenë gjithashtu në gjendje të ofrojmë mbështetje për përpjekjet civile për të përballuar COVID-19. Nëpër vendet e NATO-s, ne kemi parë rolin jetësor që kanë luajtur forcat tona të armatosura për të ndihmuar në shpëtimin e jetës. Deri më tani, rreth 350 fluturime kanë shpërndarë qindra tonë furnizime kritike në të gjithë botën. Në të gjithë Aleancën, gati gjysmë milioni trupa kanë mbështetur reagimin civil. Ndërtimi i pothuajse 100 spitaleve në terren. Sigurimi i kufijve dhe ndihma me testimin. Për shembull, Bundeswehr airtlifted dhjetë milion maska për fytyrën përmes një aranzhimi strategjik të aeroplanit të mundësuar nga NATO. Gjermania ka ndihmuar aleatët e tjerë duke siguruar furnizime mjekësore dhe transportin e pacientëve. NATO aktualisht është duke u përgatitur për një valë të dytë të mundshme të koronavirusit. Ne kemi rënë dakord për një plan të ri operacioni për të siguruar mbështetje për Aleatët dhe partnerët tanë. Një stok i ri i pajisjeve dhe furnizimeve mjekësore dhe një fond i ri për të na mundësuar marrjen e shpejtë të furnizimeve dhe shërbimeve të mëtejshme. Shumë aleatë tashmë kanë ofruar të dhurojnë për grumbullimin e rezervave dhe kontribuojnë në fond, në një shenjë të qartë të unitetit dhe solidaritetit të Aleancës.

Por virusi ka ekspozuar dobësi në rezistencën tonë. Për shembull, ne jemi mbështetur shumë në zinxhirët e furnizimit global për pajisjet thelbësore mjekësore. Dhe kështu, aleatët kohët e fundit morën vendime për të forcuar kërkesat për rezistencë kombëtare. Duke marrë llogari më të madhe për kërcënimet në internet, sigurinë e zinxhirëve tanë të furnizimit dhe pasojat e pronësisë së huaj dhe kontrollit të infrastrukturës kritike, të tilla si qendrat e transportit dhe energjia. Pandemia gjithashtu ka çuar në një rritje të dezinformatave dhe propagandas, me synimin për të minuar demokracinë tona dhe për të thelluar ndarjet, gjithashtu duke insinuar që aleatët e NATO-s janë përgjegjës për virusin dhe se regjimet autoritare janë më të mira se demokracinë në mbajtjen e njerëzve të tyre të sigurt. NATO i ka kundërshtuar me veprime konkrete të solidaritetit, me fakte të qarta duke rëzuar mashtrimet dhe gjithashtu duke bashkëpunuar me aktorë të tjerë ndërkombëtarë siç janë Bashkimi Evropian, G7 dhe Kombet e Bashkuara. Këto përpjekje



dezinformuese synojnë të gjithë ne, dhe rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla.

Dhe ne të gjithë kemi një interes të themi të vërtetën dhe t'i mbështesim vlerat tona përmes solidaritetit global.

Arsyeja e dytë pse NATO-s i duhet një qasje globale është paqëndrueshmëria dhe terrorizmi përtej kufijve

tanë. Një nga mësimet nga përvoja jonë në Afganistan, ku Gjermania ka një rol kryesor, ka qenë rëndësia e trainimit të forcave lokale. Kështu që ata mund të stabilizojnë më mirë vendet e tyre. Sigurisht, NATO duhet të jetë në gjendje të ndërhyjë me një numër të madh të forcave luftarake kur të kemi nevojë. Por parandalimi është gjithmonë më i mirë sesa ndërhyrja.

Duke u përqendruar në trajnime dhe ndërtim të kapaciteteve lokale, duke qenë një aleancë trajnime, ne mund të zvogëlojmë gjasat që ndonjëherë do të na duhet të ndërhyjmë. Shikoni ISIS-in. Vitet e fundit, bashkësia ndërkombëtare ka bërë përparime të mëdha. ISIS nuk kontrollon më territorin në Irak ose Siri. Por mbetet një kërcënim. Ne duhet të bëjmë gjithçka mundemi për të mbështetur partnerët tanë. Kështu që nuk mund të kthehet kurrë. Kjo është arsyeja pse ne po trajnojmë forcat lokale në Irak. Kështu që ata mund të luftojnë më mirë ISIS-in. Pa nevojë për një prani të NATO-s në shkallë të gjerë. Ne po punojmë edhe me partnerë të tjerë, të tilla si Tunizia dhe Jordania, për të rritur stabilitetin dhe sigurinë, për ata, dhe për të gjithë ne.

Dhe një arsye e tretë pse NATO duhet të marrë një qasje më globale është ngritja e Kinës. Së shpejti Kina do të jetë ekonomia më e madhe në botë. Është një udhëheqës global në teknologjitë e reja dhe gjithashtu ka buxhetin e dytë më të madh në botë për mbrojtjen. Rritja e Kinës paraqet mundësi, veçanërisht për ekonominë tona dhe tregtinë tonë. Prandaj është

e rëndësishme të vazhdojmë të angazhohemi me Kinën. Kina nuk është kundërshtar e NATO-s. Por ne duhet të kuptojmë plotësisht se çfarë do të thotë ngritja e saj për ne - dhe për sigurinë tonë. Është e qartë se Kina nuk i ndan vlerat tona, Demokracia, liria dhe sundimi i ligjit. Ne e shohim këtë në Hong Kong, ku ligji i ri i sigurisë minon autonominë e tij dhe lirinë e qytetarëve të saj. Me burgosjen e dhjetëra mijëra Uighurs në të ashtuquajturat "kampe riedukimi". Me përdorimin e Inteligjencës Artificiale dhe njohjen e fytyrës për të monitoruar dhe kontrolluar qytetarët kinezë. Dhe vetëm muajin e kaluar, ne e pamë atë kur Kina vendosi sanksione ekonomike ndaj Australisë pasi ajo drejtoi thirrje për një hetim të pavarur mbi origjinën e COVID-19. Mbaj mend kur isha kryeministër, dhe Komiteti Norvegjez Nobel i dha çmimin e paqes disidentit kinez Liu Xiaobo. Qeveria kineze ngriu marrëdhëniet politike dhe vendosi sanksione në shenjë hakmarrjeje. Pra, ekziston një model i qartë i sjelljes autoritare në vendi dhe rrit besueshmërinë dhe ngacmimin jashtë vendit. Mënyra më e mirë për të përballuar secilën prej këtyre sfidave globale, për t'iu mbajtur shoqëritë tona të sigurta dhe njerëzit tanë, është që Evropa dhe Amerika e Veriut të vazhdojnë të qëndrojnë së bashku dhe që ne të marrim një qasje më globale, duke punuar edhe më ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë për të mbrojtur vlerat tona në një botë më konkurruese, partnerë afër dhe larg-si Finlanda dhe Suedia, por edhe Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut.

Qëllimi i "NATO 2030" është një Aleancë që është e fortë ushtarake. Më e fortë politikisht dhe më globale. Për të më mbështetur me këtë, unë kam emëruar një grup, të kryesuar nga ish ministri i Mbrojtjes gjermane, Thomas de Maizière. Ky është një pjesë e një procesi konsultimi që do të informojë rekomandimet e mia drejtuesve të NATO-s kur ata takohen vitin e ardhshëm.

Ne nuk kemi nevojë për të rikrijuar NATO-n. Por duhet të pyesim se si mund ta bëjmë Aleancën tonë më të fortë dhe më efektive. Gjermania ka një rol të rëndësishëm. Si ekonomia më e madhe në Evropë, me buxhetin më të madh të mbrojtjes në Bashkimin Evropian, drejtuesin e një grupi betejave në Lituani, kontribues në operacionet në Afganistan dhe Kosovë, dhe nga nesër, mbajtësi i Presidencës së BE. Gjermania ka një përgjegjësi kryesore për të ndihmuar në forcimin e NATO-s për dekadën e ardhshme. Këto dhjetë vitet e ardhshme do të jenë sfiduese për të gjithë ne. Por kur Evropa dhe Amerika e Veriut qëndrojnë së bashku, ne jemi të fortë dhe jemi të sigurt. Aleanca e NATO-s është 30 demokraci. Secili me politikën, historinë dhe gjeografinë e vet. Gjithmonë do të kemi dallimet tona. Por NATO mbetet gurthemeli i sigurisë sonë kolektive dhe përmes NATO-s, ne mund të vazhdojmë të jetojmë në paqe dhe liri.

NATO bën thirrje për një qasje globale, për të adresuar sfidat globale

Më 29 qershor 2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană mori pjesë në Takimin Vjetor të Këshillit Evropian të Marrëdhënieve me Jashtë (ECFR). Duke folur në një seancë për "Bashkëpunimin e Sigurisë pas Brexit", ai nënvizoi se e ardhmja e Evropës është e lidhur pazgjidhshmërisht me të ardhmen e Aleancës Transatlantike. Duke theksuar rëndësinë e NATO-s si një forum i domosdoshëm për bashkëpunimin e sigurisë, ai theksoi se NATO dhe BE janë partnerë të natyrshëm, duke punuar së bashku për të siguruar paqen dhe prosperitetin në Evropë, e cila është bërë edhe më

thelbësore në këto kohë sfiduese. Duke folur për krizën COVID-19, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi se bashkëpunimi NATO-BE është intensifikuar më tej përgjatë javëve të fundit për të forcuar rezistencën e shoqërive tona. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përfundoi duke kërkuar një qasje globale për të adresuar sfidat globale. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit më të ngushtë midis partnerëve për të mbrojtur vlerat e përbashkëta dhe interesat e përbashkëta. Ai identifikoi nevojën për të bashkëpunuar ngushtë me vendet dhe organizatat, përfshirë BE-në, për të mbrojtur rregullat globale dhe institucionet që e kanë mbajtur botën të sigurt për dekada.



MIRCEA GEOAÑA NË FORUMIN E BRUKSELIT

NATO po përgjigjet në unitet ndaj pandemisë

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană foli në Forumin e Brukselit në Fondin Marshall Gjerman më 29 qershor 2020. Së bashku me Zëvendës Sekretarin e Shteteve të Bashkuara Stephen Biegun, ata diskutuan sfidat e sigurisë në kontekstin COVID-19. "Sfida më e madhe për NATO-n gjatë kësaj krize është mjaft e thjeshtë sepse kjo është zemra e misionit tonë: është të sigurohemi që kriza shëndetësore dhe rënia ekonomike nuk do të bëhen

një krizë sigurie gjithashtu", tha ai. "Ne kemi parë solidaritet në veprim. Kjo është diçka, besoj, që dëshmon se Aleanca jonë është e fortë, është jetësore dhe po nxjerr mësim nga kjo gjë". Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi më tej rëndësinë e solidaritetit ndërkombëtar në luftimin e sfidave në të ardhmen. "Ne jemi të detyruar si kombe demokratike të dalim nga kjo pandemi më e fortë", tha ai. "Mësimi i vetëm që mund të nxjerrim nga kjo që këtu në Evropë, përtej Atlantikut, në NATO,

me të gjithë aleatët e tjerë globalë, nga Azia-Paqësori, nga India, nga shumë vende të tjera, ne duhet të bashkojmë forcat sepse ky është vetëm fillimi i një përsheptimi të një konkurrence globale ku vlerat tona, mënyra jonë e jetesës kërcënohen dhe rrezikohen. Kjo është ajo për të cilën bëhet fjalë për NATO-n". Forumi i Brukselit bashkon udhëheqës, politikëbërës dhe ekspertë të Evropës dhe Amerikës së Veriut, për të diskutuar sfidat aktuale transatlantike.

Trajnime komplekse dhe sfida luftarake

NATO fillon stërvitjen detare "Dynamic Mongoose"

Marrin pjesë nëndetëse dhe anije sipërfaqësore nga Franca, Gjermania, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja, nën Komandën e Nëndetëses së NATO-s

Ushtrimi 'Dynamic Mongoose' i NATO-s filloi në Veriun e Lartë në 29 qershor 2020. Anijet, nëndetëset, si dhe avionët dhe personeli nga 6 kombe aleate po takohen në brigjet e Islandës për luftën kundër-nëndetëseve (ASW) dhe trajnime luftarake anti-sipërfaqësore.

Nëndetëset nga Franca, Gjermania, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara nën Komandën e Nëndetëses së NATO-s po bashkohen me anije sipërfaqësore nga Kanadaja, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Si komb pritës, Islanda po ofron mbështetje logjistike në Reykjavik.

Për të përmirësuar mjedisin e simuluar me shumë kërcënime, aeroplanët e patrullimit detar nga Franca, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara mbështesin ushtrimin. Në total marrin pjesë 5 anije sipërfaqësore, 5 nëndetëse, 5 aeroplanët e patrullimit detar.

Qëllimi i Dynamic Mongoose është t'u sigurojë të gjithë pjesëmarrësve trajnime komplekse dhe sfiduese të luftës për të përmirësuar ndërvprueshmërinë dhe aftësinë e tyre në aftësitë luftarake Anti-Nëndetëse dhe Anti-Sipërfaqësore, duke pasur parasysh kujdesin e duhur.

"Ushtrimet sot shfrytëzojnë mundësi për NATO-n dhe kombet aleate për të mprehur aftësitë e luftës duke u përqëndruar në aftësitë e nivelit të lartë, përfshirë Luftën Anti-Nëndetëse. Dynamic Mongoose do të sigurojë që ne të mbetemi të përgatitur për operacione në paqe, krizë dhe konflikt. Në këtë drejtim, unë vlerësoj mbështetjen e jashtëzakonshme të kombit pritës të Islandës dhe atyre kombeve që kanë kontribuar me forca. Vullneti i 'Dinamik Mongoose', jam i sigurt, do të jetë një ushtrim shumë efektiv", tha zëvendës admirali Keith Blount, komandanti i Komandës Detare Aleate të NATO-s.

"Ushtrimi vjetor i Anti-Nëndetës, Dynamic Mongoose, mbetet një nga ushtrimet më sfiduese dhe një mundësi e shkëlqyeshme për forcat detare të vendeve të NATO-s për të praktikuar dhe vlerësuar aftësitë e tyre të luftës



anti-sipërfaqësore dhe anti-nëndetëse në mjedisin sfidues të Atlantikut të Veriut. Ky ushtrim është një mundësi unike për të forcuar aftësitë luftarake të forcave detare në të gjitha dimensionet e luftës anti-sipërfaqësore dhe anti-nëndetëse në një mjedis shumëkombësh dhe shumë-kërcënues", tha admiral E. Andrew Burcher, komandanti i nëndetëseve të NATO-s. Anijet sipërfaqësore do të kenë mundësinë

për të kryer një sërë operacionesh luftarake të nëndetëseve. Nëndetëset do të presin guajtje dhe do të gjuhen, duke koordinuar ngushtë përpjekjet e tyre me pjesëmarrësit e ajrit dhe të sipërfaqes. Për shkak të kërcënimit COVID-19, masat e marra nga autoritetet islandeze dhe forcat e vendeve kontribuuese do të ndiqen rreptësisht nga të gjitha palët gjatë vizitave dhe trainimeve në port.

75 vjetori i Kartës së KB

NATO dhe KB mbajnë konsultime për përgjigjen e COVID-19

NATO dhe Kombet e Bashkuara zhvilluan bisedime vjetore praktikisht më 29 qershor 2020, me një fokus të fortë në luftën kundër COVID-19. "Që nga fillimi i krizës COVID-19, ne kemi intensifikuar bashkëpunimin tonë me KB ndërsa përpiqemi të forcojmë rezistencën e shoqërive tona. Si pjesë e një përgjigje globale, NATO po ndihmon KB-në me transportin në ajër dhe aftësi të tjera kritike që janë shumë të nevojshme në këtë kohë", tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană.

Ai mori pjesë në këto bisedime së bashku me Ndihmës Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s për Çështjet Politike dhe Politikën e Sigurisë, Bettina Cadenbach dhe, në anën e KB, Nënsekretarin e Përgjithshëm për Çështjet Politike dhe Ndërtimin e Paqes, Rosemary DiCaro, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm për Operacionet e Paqes Jean -Pierre Lacroix dhe Nënsekretarin e Përgjithshëm për Mbështetje Operacionale Atul Khare. Duke shënuar 75 vjetorin e Kartës së KB, NATO dhe KB u zotuan të punojnë së bashku në fusha, përfshirë ndikimet gjinore të pandemisë të koronavirusit, kujdesin mjekësor të specializuar dhe një sërë fushash teknike.



PROJEKTI KA VLERËN 20 MILION EURO

NATO është gati për të pritur trupat aleate në Estoni

Një strukturë e re e infrastrukturës së NATO-s sapo hapi dyert e saj në Bazën Tapa në Estoni. Qendra është në gjendje të presë dhe lehtësojë lëvizjen përpara të forcave të NATO-s, duke përfshirë Task Forcën e përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF), dhe do të përdoret për ushtrime dhe parapozicionim të pajisjeve. Shumica e projektit, me vlerë 20 milion euro, është financuar përmes Programit të Investimeve të Sigurisë së NATO-s (NSIP). Infrastruktura e re përfshin kazermat për akomodimin e trupave, hapësirën e depozitimit të pajisjeve dhe automjeteve, një qendër mjekësore dhe një helipad, (platformë për uljen e helikopterëve). Objekti do të shërbejë si një kamp fushor i gatshëm për përdorim për



ushtrime me njoftime të shkurtra dhe vendosje. Do të ndihmojë në sigurimin e fleksibilitetit dhe lëvizjes së shpejtë të forcave të NATO-s në të


gjithë territorin e aleatëve balltikë.

"Projekti në Tapa tregon ndarjen e barrës në veprim. Është gjithashtu një shembull i aleatëve që përbushin angazhimet që ata morën në Samitin e Uellsit në 2014 dhe Samitin e Varshavës në vitin 2016, për të rritur aftësinë e NATO-s për të forcuar shpejt dhe në mënyrë efektive aleatët e saj Lindorë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Ky është vetëm një nga më shumë se 200 projekte të nisura nga Aleatët e NATO-s për të mundësuar Planin e Veprimit të Gatishmërisë. Përmes financimit të përbashkët, infrastruktura për të mbështetur parashikimin e furnizimeve ushtarake, dhe pritjes, organizimit dhe trajnimit, është aktualisht në ndërtim e sipër në tetë kombet e NATO-s.



Aftësitë ushtarake të NATO-s funksionojnë së bashku

Ushtrimi i Koalicionit Warrior-veprimtaria më e madhe e ndërveprimit të NATO-s - u tërhoq në një mbyllje të suksesshme më 25 qershor 2020. Ushtrimi, i cili u zhvillua praktikisht këtë vit, pa pjesëmarrësit të hynin nga vendet e provave në San Diego në Bregun Perëndimor të SHBA-së deri në Ankara, Turqi. Qëllimi i ushtrimit ishte të sigurohet që aftësitë ushtarake të NATO-s të mund të funksionojnë pa probleme së bashku, si dhe me ato të partnerëve dhe organizatave të tjera. Pandemia COVID-19 e solli stërvitjen në internet, e cila paraqiti një sfidë shtesë për pjesëmarrësit, të cilët duhej të përtërijnë dhe adaptojnë metodat, proceset dhe teknologjitë e tyre të punës. Pandemia ishte gjithashtu e pranishme si një nga fushat e përqendrimit të stërvitjes, e cila merrej me ndërveprimin midis aftësive mjekësore të kombeve të ndryshme. Duke përdorur super kompjutera, ekspertët testuan shkëmbimin e shënimeve elektronike shëndetësore, gjurmimin e të dhënave të pacientëve dhe monitorimin e përhapjes së sëmundjeve. Ky lloj i testeve mund të ndihmojë në shpëtimin e jetës duke përmirësuar ndarjen e të dhënave në objektet mjekësore.



Ministri Anton Quni, përgëzoi Komandën e Forcave Tokësore për realizimin e këtij ushtrimi në mënyrë profesionale, ndër të tjera ai vlerësoi lartë faktin edhe pse gjendemi në kohë të pandemisë COVID-19, ushtarët e FSK-së janë në formacion të plotë duke kryer ushtrimet e planifikuara, me disiplinë dhe përkushtim të madh, duke treguar nivel të lartë profesionalizmi dhe aftësi taktike operuese.



KOMANDA E FORCAVE TOKËSORE

Kursi "Komando-Bereta" në aeroportin e Gjakovës

U demonstruan kapacitetet njerëzore dhe teknike si dhe niveli i arritjeve profesionale të ushtarëve të FSK-së

Me qëllim të njoftimit nga afër me operacionet e njësisë të FSK-së, Ministri i Mbrojtjes Anton Quni, së bashku me stafin e tij, vizitoi njësitë e Komandës së Forcave Tokësore (KFT), që po realizojnë kursin 'Komando - Bereta' në aeroportin e Gjakovës. Ministrin Quni, gjatë vizitës u prit nga komandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Fadil Hadergjonaj, si dhe oficerë të lartë të Komandës. Fillimisht, gjenerali Hadergjonaj e njoftoi Ministrin Quni me objektivat e këtij ushtrimi, kapacitetet njerëzore dhe teknike si dhe me nivelin e arritjeve profesionale të ushtarëve të FSK-së, gjatë këtij ushtrimi.

Ndërsa, nga ana e tij, Ministri Anton Quni, përgëzoi Komandën e Forcave Tokësore për realizimin e këtij ushtrimi në mënyrë profesionale, ndër të tjera ai vlerësoi lartë faktin edhe pse gjendemi në kohë të pandemisë COVID-19, ushtarët e FSK-së janë në formacion të plotë duke kryer ushtrimet e planifikuara, me disiplinë dhe përkushtim të madh, duke treguar nivel të lartë profesionalizmi dhe aftësi taktike operuese.

Ministri Quni para oficerëve, nëniferëve dhe ushtarëve të njësisë përkatëse u zotua për ofrimin e mbështetjes maksimale për të avancuar edhe më tej në përmbushjen e detyrës së shenjtë, në kuadër të misionit të mbrojtjes së vendit dhe sigurisë së qytetarëve tanë.



Gjeneral brigade Harris mbaron misionin si shef i Shtabit të KFOR-it

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni i shoqëruar nga Komandanti i FSK-së gjeneralletjënant Rrahman Rama dhe shefi i Stafit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, morën pjesë në ceremoninë lamtumirëse të shefit të Shtabit të KFOR-it gjeneral brigade Shawn A. Harris i mbajtur në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Film City. Në pritjen personale lamtumirëse, gjeneral Harris i shoqëruar nga pasardhësi i tij gjeneral Larry Henry, falënderoi ministrin Quni dhe gjeneral Ramën për bashkëpunimin e ngushtë dhe u uroi suksese në realizimin e objektivave të synuar në zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri Quni e falënderoi gjeneralin amerikan dhe shprehu mirënjohjen e thellë për bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm gjatë mandatit të tij në detyrën tejet të rëndësishme siç është përgjegjësia e Shefit të Shtabit të KFOR-it. Ministri Quni dhe gjeneral Rama i uruan gjeneral Harris-it suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e reja në kuadër të forcave mike amerikane si dhe përgëzuan pasardhësin e tij gjeneral Henry-n duke shprehur gatishmërinë e plotë për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen në mes FSK-së dhe KFOR-it.

MINISTRI QUNI MERR MESAZH URIMI NGA HOMOLOGU TURK AKAR

Turqia do mbështesë realizimin e objektivave të MM dhe FSK

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni priti atasheun ushtarak të Turqisë në Kosovë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz. Duke e falënderuar për vizitën, edhe këtë herë, Ministri Quni shprehu mirënjohjen për mbështetjen e madhe në të gjitha aspektet që ka ofruar dhe vazhdon të ofroj qeveria dhe ushtria turke në ndërtimin e FSK-së dhe perspektivën zhvillimore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij, Kolonel Ersoz, e falënderoi ministrin Quni për mikpritjen dhe solli letërën me mesazhin e urimit për detyrën e ministrit nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Turqisë Hulusi Akar si dhe ambasadorit të Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar. Në mesazhet e urimeve, theksohet intensifikimi i bashkëpunimit bilateral dhe fuqizimi i partneritetit si dhe shprehet vullneti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave Turke për vazhdimin e përkrahjes në të




gjitha fushat në funksion të realizimit të objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Nga ana e tij Ministri Quni, shprehu kënaqësinë për urimet me mesazhet miqësore dhe vullnetin për vizita të ndërsjella me homologun Akar si dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral duke vlerësuar lart rolin e

Turqisë si vend anëtar i NATO-s në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Në këtë takim Kolonel Ersoz shoqërohej nga këshilltari ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandantit të FSK-së nga FA të Turqisë, Kolonel Mehmet Kurtpinar.

Gjeneral Rama pret këshilltarin turk, Kolonel Kurtpinar

Komandanti i FSK-së gjeneralletjënant Rrahman Rama priti në takim lamtumirës oficerin e forcave turke kolonel Mehmet Kurtpinar i cili shërbeu në cilësi të këshilltarit ushtarak të tij dhe ministrit të mbrojtjes Anton Quni. Gjeneral Rama e falënderoi për bashkëpunimin dhe angazhimin e tij në këshilldhënie profesionale si dhe i dëshiroi suksese në detyrat dhe përgjegjësitë në të ardhmen. Nga ana e tij, kolonel Kurtpinar, shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e ngushtë si dhe vlerësimin e lartë për cilësinë e lidhshimit të treguar dhe dinamikës së realizimit të aktiviteteve të planifikuara, duke potencuar edhe nivelin e lartë të ministrisë dhe forcës gjatë menaxhimit të krizës së shkaktuar nga COVID-19.

Në fund, me motivacion për shërbimin vetëmohues, gjeneral Rama, kolonelin Akpinar e dekoroi me medalje. Kurse në emër të ministrit Quni, medaljen me motivacion për kontributin dhe përkrahjen e dëshmuar gjatë misionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së ia dorëzoi, këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi.



“Të ardhurat e të gjithë pjesëtarëve u rritën. Unë premtova kompensim qiraje prej 7000 denarë, sot të gjithë ata që plotësojnë kushtet marrin kompensim mbi 8000 denarë, çdo muaj. Sot, paga dhe të ardhurat e pjesëtarëve të Armatës janë rritur në mes 50 dhe 60 përqind, kemi blerë makina të reja inxhinierike, kemi porositur automjete të reja të blinduara”, - tha Shekerinska



MINISTRJA RADMILLA SHEKERINSKA

Uniformat e reja, pagat më të larta dhe pajisje të reja për armatën

Pagat dhe të ardhurat e pjesëtarëve të Armatës janë rritur me 50 dhe 60 përqind, kompensim qiraje 8000 denarë çdo muaj, etj.



